



## Periodiku AMF

### Zhvillohet seminari mbi përdorimin e SNRF-ve për qëllime rregullatore dhe të kujdesshme

Qendra e Bankës Botërore për Reformën mbi Raportimin Financiar, në kuadër të programit REPARIS, zhvilloi gjatë periudhës 8-9 shkurt 2011, në Vjenë, Austri, seminarin mbi përdorimin e SNRF-ve për qëllime rregullatore dhe të kujdesshme.

*Vijon në faqen 2*

### Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

#### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar 2011 arritën shifrën 857,208 mijë lekë, përkundrajt 634,456 mijë lekë të realizuara në janar 2010 ose 35.11% më shumë.

*Vijon në faqen 2*

### Ngjarje dhe zhvillime të tjera

#### Zhvillohet konferenca vjetore 2011 e legjislacionit evropian mbi sigurimet

Gjatë periudhës 24-25 shkurt 2011 në Trier, Gjermani, në ambientet e Akademisë Evropiane të Ligjit u zhvillua Konferenca Vjetore 2011 e legjislacionit evropian mbi sigurimet.

*Vijon në faqen 5*

#### Zhvillohet mbledhja e komiteteve të IAIS-it

Gjatë periudhës 16 -18 shkurt 2011, në Basel, Zvicër, u zhvillua mbledhja e radhës së komiteteve të IAIS-it. Në këtë mbledhje merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore, anëtarë të IAIS-it, si

dhe vëzhgues të ndryshëm nga industria.

*Vijon në faqen 5*

#### Zhvillohet seminari mbi komunitetin e praktikës së raportimit financiar

Gjatë periudhës 3-4 shkurt, në Vjenë, Austri, Qendra për Reformën Financiare pranë Bankës Botërore, zhvilloi seminarin mbi komunitetin e praktikës së raportimit financiar.

*Vijon në faqen 6*

#### Zhvillohet seminari mbi kuadrin e Solvency II dhe standardet e IAIS-it mbi aftësinë paguese

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI), zhvilloi gjatë periudhës 22-24 shkurt, në Basel, Zvicër, seminarin mbi kuadrin e Solvency II dhe standardet e IAIS-it mbi aftësinë paguese.

*Vijon në faqen 7*

### Edukimi i konsumatorit

#### Bazat e Risigurimit

*(Material i përpunuar, i autorit Rodolfo Wehrhahn, nxjerrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)*

*Vijon nga numri i kaluar...*

#### Pjesëmarrësit e industrisë së risigurimit

Siç u diskutua më sipër, pjesëmarrësit kryesorë në industrinë e risigurimit janë risiguresit profesionistë, retroconsionarët dhe shoqëritë e sigurimeve. Ndërmjetësit e risigurimit gjithashtu luajnë një rol themelor në vendosjen e programeve të risigurimeve, në veçanti kur trajtohen programe të veçanta. Siguresit “captive”, rezervat e përbashkëta (pools) dhe risiguresit e huaj plotësojnë industrinë e risigurimit.

*Vijon në faqen 9*

## Në këtë numër:

Zhvillohet seminar mbi përdorimin e SNRF-ve për qëllime rregullatore dhe të kujdesshme

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

2

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

5

Edukimi i konsumatorit

9

## Zhvillohet seminari mbi përdorimin e SNRF-ve për qëllime rregullatore dhe të kujdesshme

Qendra e Bankës Botërore për Reformën mbi Raportimin Financiar, në kuadër të programit REPARIS, zhvilloi gjatë periudhës 8-9 shkurt 2011, në Vjenë, Austri, seminarin mbi përdorimin e SNRF-ve për qëllime rregullatore dhe të kujdesshme.

Objektivat e seminarit ishin:

- Përditësimi i pjesëmarrësve me zhvillimet e fundit mbi rregullimin dhe kontabilitetin bankar, sidomos me rregullat e Basel III dhe progresin e bërë në standardin ndërkombëtar të raportimit financiar SNRF 9.
- Informimi i pjesëmarrësve në lidhje me zhvillimet e fundit në rregullimin dhe kontabilitetin në sigurime, me fokus të posaçëm tek standardi i përditësuar për sigurimin (SNRF 4) si dhe direktivën evropiane mbi sigurimet (Solvency II).

Gjatë seminarit u prezantuan zhvillimet e fundit institucionale, ndryshimet në lidhshmërinë e IASB, si dhe progresi i bërë në procesin e konvergencës mes SNRF-ve të IAS-it dhe GAAP-it të FASB-së. Fushat kryesore të mosmarrëveshjeve konsistojnë në metodat që duhet të përdoren për të përcaktuar vlerën e drejtë, sidomos në vlerësimin e huave bankare.

Në vazhdim u diskutua lidhur me zhvillimet në kontabilitetin për instrumentet financiarë, si dhe rregullimin e tregjeve bankare. IASB është në procesin e prodhimit të një standardi të ri për instrumentet financiarë (IFRS 9). Faza e parë e këtij projekti ka përfunduar (klasifikimi dhe matja), por Bashkimi Evropian nuk e ka zbatuar akoma këtë standard. Puna në fazën e dytë (zhvlerësimi) dhe në fazën e tretë (kontabiliteti i hedging) akoma vazhdon dhe mendohet të përfundojë nga mesi i vitit 2011. Çështje akoma të papërfunduara konsistojnë në, se si duhet të kontabilizohen humbjet e pritshme në të

ardhmen, sidomos nëse ato duhet të shpërndahen apo të ngarkohen në fillim. Tashmë është e qartë që SNRF 9 është e orientuar nga parimet më shumë se sa standardi SNK 39 që ajo zëvendëson.

Pjesë e seminarit ishte dhe diskutimi mbi rregullat e Basel III. Këto rregulla rritin peshat specifike të riskut për disa aktive, shtrëngojnë (kufizojnë) përkufizimin e kapitalit (duke e kufizuar atë në kapitalin bazë) dhe rritin normat e kapitalit të kërkuar. Përveç këtyre, Basel III, ka sjellë dhe dy standarde në lidhje me likuiditetin - mbulimi i likuiditetit (LC), i cili mbulon periudhën afatshkurtër dhe një raport tjetër (raportin neto të financimit të qëndrueshëm) për periudhën afatmesme. Kërkesat më të larta për kapital për ekspozimet në instrumente derivativë, si dhe kërkesat e tjera në lidhje me kapitalin kanë për qëllim të lehtësojnë problemet “shumë të lidhura për të falimentuar”, apo “shumë të mëdha për të falimentuar”, të cilat ishin në qendër të krizës së fundit financiare.


Çështje të lidhura me sigurimet dhe rregullimin e sigurimeve ishin një pjesë tjetër e rëndësishme e seminarit. IASB ka publikuar një draft ekspozimi të SNRF 4 për kontratat e sigurimit në korrik 2010 (e njohur kjo si faza e dytë e SNRF 4). Zhvillimi i këtij standardi të ri ka marrë mjaft kohë diskutimi fillestar mbi të e është publikuar në 2007. Pritet që standardi final të publikohet në qershor 2011. Në lidhje me rregullimin e sigurimeve, korniza e direktivës “Solvency II” është adaptuar tashmë nga Komuniteti Evropian por disa nga detajet e zbatimit akoma duhet të përpunohen më tej. Solvency II dhe SNRF 4 kanë objektiva të ndryshme por megjithatë ka mbivendosje të konsiderueshme mes tyre, si rrjedhim është akoma e mundur të bëhen rregullime në SNRF 4 në mënyrë që plotësohen sa më mirë kërkesat e Solvency II.

**Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura**

**Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar 2011**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar 2011 arritën shifrën 857,208 mijë lekë, përkundrejt 634,456 mijë lekë të realizuara në janar 2010 ose 35.11% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 62.43% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 37.57% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 143.81% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 24.70% të sigurimeve të Jo-Jetës. 84.23% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 15.77% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës.

Në janar 2011 u nënshkruan rreth 97,046 kontrata sigurimi, ose rreth 134.93% më shumë se në 2010.



## Volumi i primit të shkruar bruto, janar (2010-2011)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2010	2011
<b>Janar</b>		
A) Sigurim i Jetës	55,461	135,219
B) Sigurim i Jo-Jetës	578,994	721,989
a) Sigurimi i Detyrueshëm	285,535	322,059
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	293,459	399,930
c) Risigurimi	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>634,456</b>	<b>857,208</b>

## Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar 2011, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 37.57% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar 2011, arritën 188,069 mijë lekë, ose 11.06% më pak se në janar 2010.

Në janar 2011, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 116,264 mijë lekë, ose rreth 110.05% më shumë se në janar 2010.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janarit 2011 arritën në 17,726 mijë lekë, apo 5.34% më pak se në janar të 2010.

## Sigurimet vullnetare

Në janar 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 535,148 mijë lekë, ose 53.37% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 399,930 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 32.29% të pasuara nga, sigurimi kasko me 12.89% dhe nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 11.35%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit dhe sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar 2011, arritën në 88,593 mijë lekë, 219.32% më shumë se në janar 2010. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 90.17% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në janar 2011 arritën

në rreth 135,219 mijë lekë, ose rreth 143.81% më shumë se në janar 2010. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

## Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 41.75% të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 32.52 % të primeve.

## Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar 2011 kapi vlerën 198,517 mijë lekë, ose 31.19% më shumë se në janar 2010. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 116,381 mijë lekë, apo 58.63% të totalit.

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### Zhvillohet konferenca vjetore 2011 e legjislacionit evropian mbi sigurimet

Gjatë periudhës 24-25 shkurt 2011 në Trier, Gjermani, në ambientet e Akademisë Evropiane të Ligjit u zhvillua Konferenca Vjetore 2011 e legjislacionit evropian mbi sigurimet.

Qëllimi i kësaj konference ishte diskutimi lidhur me çështjet e ndryshme në fushën e sigurimeve dhe zhvillimet e fundit në këtë treg, parë nga aspekti i Bashkimit Evropian.

Kryetari i Komitetit Evropian për Mbrojtjen e Konsumatorit, Z. Viktor Rod, në fjalën e hapjes, bëri një prezantim lidhur me pasojat e krizës ndërkombëtare në tregun e sigurimeve, si dhe zgjidhjet e mundshme të problemeve të lindura nga kjo krizë.

Gjatë ditës së parë të konferencës u diskutuan çështjet dhe problemet e përfshirjes në tregun evropian të sigurimeve, të skemës së garancisë të sigurimit. Në dritën e krizës së fundit financiare dhe me qëllim forcimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe të garantimit të stabilitetit të tregut të sigurimeve, Bashkimi Evropian po merr në konsideratë hartimin e një direktive lidhur me skemën e garancisë. Në këtë konferencë u diskutuan jo vetëm problemet dhe çështjet e

hasura nga BE në këshillime të shumta, por çështja në fjalë u diskutua edhe nga perspektiva e konsumatorit dhe e industrisë së sigurimeve.

Në vazhdim u diskutua tema e Direktivës Evropiane të Ndërmjetësimit (IMD). Pesë vjet pas përfundimit të zbatimit të IMD-së në legjislacionin përkatës të çdo vendi anëtar të BE-së, copëzimi i vazhdueshëm i tregut evropian të sigurimeve dhe ndryshimet në metodat rregullatore, kanë sjellë nevojën e rishikimit të kësaj Direktive. Komisioni Evropian, në kuadër të këtyre angazhimeve, ka ndërmarrë një këshillim publik, i cili pritet të përfundojë brenda vitit 2011, në mënyrë që të mbledhë mendimet e palëve të interesuara lidhur me ndryshimet e nevojshme të kësaj direktive. Në përfundim të ditës së parë, përfaqësues të KE-së, dhanë një pasqyrë të plotë të problemeve dhe mangësive të IMD-së e gjithashtu edhe të procesit të hartimit të ndryshimeve të kësaj direktive.

Në takim u diskutua lidhur me iniciativat e nisura nga BE për harmonizimin e ligjit të kontratave të sigurimit, si dhe efekti i mundshëm i një instrumenti alternativ mbi shërbimet e cross border.

Pjesa e fundit e Konferencës vjetore të Legjislacionit Evropian mbi sigurimet u fokusua në trajtimin dhe diskutimin e një instrumenti të përshtatshëm për unifikimin e ligjit të kontratave të sigurimit. Theksi u vu edhe mbi Green Paper, publikuar nga Komisioni Evropian një vit më parë me titull “Progresi drejt një Ligji Evropian për kontratat e sigurimit”.

Në fund të konferencës u shpërndanë certifikata të pjesëmarrjes për të gjithë të pranishmit, të cilët ndanë eksperiencën e tyre evropiane në fushën e sigurimeve.

### Zhvillohet mbledhja e komiteve të IAIS-it

Gjatë periudhës 16-18 shkurt 2011, në Basel, Zvicër, u zhvillua mbledhja e radhës së



komiteteve të IAIS-it. Në këtë mbledhje merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore, anëtarë të IAIS-it, si dhe vëzhgues të ndryshëm nga industria.

Mbledhja e komiteteve të IAIS-it ishte organizuar në takime të: Grupit Koordinator të ICP-ve, Komitetit Teknik të IAIS-it, Komitetit të Stabilitetit Financiar, Task Forca e ComFrame-it, si dhe Komitetit Ekzekutiv.

Në lidhje me ICP-të, Komiteti Teknik i IAIS-it kërkoi nga Komiteti Ekzekutiv:

- të shtyjë aprovimin e ICP-ve të rishikuara për në mbledhjen e përgjithshme, në përputhje me axhendën e parashikuar;
- të aprovojë përmbajtjen e ICP-ve nr. 7, 3, 23, 25, 18, 19, 21, 20, 6 dhe 11;
- të marrë në konsideratë ndikimin e rekomandimeve të FSB-ve për ICP-të 1, 2, 9, 10 dhe 24;
- të zhvillojë konsulta me anëtarët dhe vëzhguesit për herë të parë mbi: prezantimin e ICP-ve dhe Metodologjinë e Vlerësimit, ICP 8, 12, 14, dhe 22;
- të konsultohet paketa e plotë e materialit të ICP-ve për të evituar ndonjë mospërputhje;
- të konsultohet në lidhje me Rezolutën për zhvillimin e aktivitetit të sigurimeve ndër kufitar.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, FSB kërkoi nga IAIS, të sigurohej informacion dhe analizë e mëtejshme lidhur me sektorin e sigurimeve, në mënyrë të veçantë për aktivitetin e risigurimeve.

Grupi i Specialistëve të FSC-së ka vijuar punën lidhur me metodologjinë e propozuar. Ky Grup po punon për metodologjinë, bazuar në vërejtjet e FSC-së dhe informacionin nga vëzhguesit.

IAIS pritet të propozojë metodologji për të vlerësuar rëndësinë e siguruesve për mbledhjen e FSB-SCR, që do zhvillohet në muajin mars. Pas marrjes së vërejtjeve nga FSB, IAIS pritet të

propozojë metodologjitë përfundimtare në muajin qershor.

Gjatë mbledhjes u prezantua për diskutim dhe u aprovua një material lidhur me nxitjen e efikasitetit të projektit Com Frame bazuar në diskutimet e zhvilluara në mbledhjen në Miami duke përfshirë një draft mandat të Grupit të Mbikëqyrjes së Com Frame që do ngrihet brenda Komitetit Ekzekutiv, rolin e komitetit teknik për vendosjen e standardeve pjesë e Com Frame dhe rolin e forumit mbikëqyrës për aspektet praktike mbikëqyrëse lidhur me Com Frame.

Në këtë mbledhje, gjithashtu, u diskutua lidhur me programin, prezantuesit dhe hapat që do ndërmerren me organizimin e Konferencës Vjetore të IAIS-it 2011.

### **Zhvillohet seminari mbi komunitetin e praktikës së raportimit financiar**

Gjatë periudhës 3-4 shkurt, në Vjenë, Austri, Qendra për Reformën Financiare pranë Bankës Botërore, zhvilloi seminarin mbi komunitetin e praktikës së raportimit financiar, në vijimësinë e takimeve të mbajtura (i katërti i radhës) për të diskutuar lidhur me çështjet e raportimit financiar në vendet REPARIS. Seminari u organizua në kuadrin e programit “Rruga drejt Evropës - Programi i Reformës Kontabël dhe Fuqizimit Institucional (REPARIS)”.

Ndër objektivat e seminarit përmendim:

- përafrimin e ligjeve të kontabilitetit dhe kërkesave të ngjashme me acquis communautaire (kuadrin ligjor të Komunitetit Evropian);
- zgjedhjen e kërkesave të duhura për raportim financiar për forma dhe madhësi të ndryshme të njësive ekonomike brenda kornizës së acquis communautaire;
- të kuptuarit e parimeve në përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare sipas SNRF-ve, si dhe;



- sigurimin e vlefshmërisë së SNRF-ve në të gjitha gjuhët lokale.

Në ditën e parë prezantimet dhe diskutimet u fokusuan në njohjen e parimeve dhe kornizës mbi të cilat janë ndërtuar SNRF-të. Qëllimi i këtyre diskutimeve ishte të kuptuarit nga rregullatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë, të parimeve të përgatitjes dhe prezantimit të pasqyrave financiare të përgatitura sipas SNRF-ve. Këto parime lidhen kryesisht me: objektivin e raportimit financiar, karakteristikat (sasiore dhe cilësore) e raportimit financiar, kufizimet në raportimin financiar, si dhe parimet e njohjes. Të gjitha këto u ilustruan me shembuj konkretë. Objekt i prezantimeve ishte dhe aplikimi i kornizës (framework) së SNRF-ve dhe përdorimi i gjyqimit në zbatimin e tyre. Më gjerësisht u trajtua SNRF 8 dhe hierarkia lidhur me politikat kontabël që duhet të përdorin shoqëritë në varësi të faktit, nëse çështje specifike trajtohen apo jo nga SNRF-të.

Përkthimi i SNRF-ve u trajtua gjerësisht. U prezantua statusi aktual i përkthimit dhe publikimit të SNRF-ve në vendet REPARIS, si dhe përkthimi i SNRF-ve për NVM-të. Aktualisht Shqipëria ka përkthyer dhe publikon në formë elektronike SNRF-të, si dhe ka përfunduar dhe përkthimi i SNRF-ve për NVM-të. Këto përkthime përdoren edhe nga Kosova (në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta).

Në ditën e dytë, diskutimi dhe prezantimet u fokusuan më shumë në përafrimin e bazës ligjore kontabël të vendeve pjesëmarrëse (REPARIS) me kornizën ligjore evropiane. U trajtua me detaje Direktiva Evropiane 4 lidhur me kërkesat që ajo ka dhe mundësitë që ofron në aplikimin e saj. Rasti i studimit të prezantuar Kryetari i Raportimit Financiar, tregoi për eksperiencën e Mbretërisë së Bashkuar në: 1) përdorimin e mundësisë për kompanitë e vogla dhe të mesme në Direktivë; 2) përdorimin e mundësive të rregullave të IAS-it, si dhe në 3) sigurimin e një lidhjeje mes kërkesave për raportim financiar dhe

kontabilitetit për qëllime fiskale.

Në fund të seminarit u punua për hartimin e një plan veprimi për Komunitetin e Praktikës së raportimit Financiar me qëllim: 1) identifikimin e boshllëqeve mes kornizës ligjore vendase dhe kërkesave të Direktivës 4, si dhe 2) rënien dakord mbi politika të përbashkëta. Ky plan veprimi është i rëndësishëm, pasi me përjashtim të Kroacisë, vend i cili tashmë e ka bërë transpozimin e Direktivës 4 në legjislacionin vendas, vendet e tjera të rajonit po punojnë në këtë drejtim.

### **Zhvillohet seminari mbi kuadrin e Solvency II dhe standardet e IAIS-it mbi aftësinë paguese**

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI), zhvilloi gjatë periudhës 22-24 shkurt, në Basel, Zvicër, seminarin mbi kuadrin e Solvency II dhe standardet e IAIS-it mbi aftësinë paguese.

Seminari u fokusua në sqarimin e kuadrit të përgjithshëm dhe elementëve të veçantë me interes praktik të sistemit rregullator Solvency II dhe regjimeve të ngjashme në zbatim në vende të ndryshme.

Ndër temat kryesore të diskutuara gjatë seminarit, përmendim:

- **Zhvillimi i Solvency II** - Tema trajtoi qëllimin, strukturën dhe historikun e zhvillimit të kuadrit rregullator Solvency II. Pas sqarimit të mangësive të përgjithshme të sistemeve aktuale rregullatore Solvency I dhe përcaktimit të qëllimit të secilit prej tre përbërësve të Solvency II, pjesëmarrësit debatuan mbi përfshirjen e siguresve me natyrë të veçantë, si shoqëritë 'captive', në kuadrin e Solvency II, rezultatet dhe ndikimet e katër studimeve të deritanishme sasiore (Quantitative Impact Study - QIS) dhe afatet kohore për konkretizimin dhe zbatimin e kuadrit të ri rregullator.
- **Kërkesat sasiore të Solvency II** - Tema trajtoi në mënyrë të veçantë kërkesat sasiore që

kolona e parë e Solvency II i vendos siguruesve evropianë. U trajtuan parimet e përgjithshme pas kërkesave sasiore të sistemit, si parimi i vlerësimit me bazë tregu dhe analiza gjithëpërfshirëse e Bilancit, për të vazhduar me dy konceptet e aftësisë paguese, Minimum Capital Requirement (MCR) dhe Solvency Capital Requirement (SCR), shtresëzimin e kapitalit në bazë të cilësisë së zërave të ndryshëm, debatin mbi përfshirjen apo jo të fitimeve të ardhme nga policat ekzistuese në kapitalet e veta, llogaritjen e provigjoneve teknike në bazë vlere tregu apo me anë të marzhit të rikut, klasifikimin e riskqeve për tu matur nga modelet aktuariale, etj.

- **Mbikëqyrja e grupeve ndërkombëtare të sigurimit** - Tema trajtoi problemet e veçanta që mbikëqyrja e grupeve shumëkombëshe të sigurimit e cila paraqet përvojën e krizës së fundit financiare, konceptin e njësisve me peshë sistemike (Systemically Important Financial Institution-SIFI), si dhe strukturën e përgjithshme të kuadrit të përbashkët mbikëqyrës (Common Framework -ComFrame), zhvillimi i të cilit pritet të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e mbikëqyrjes së grupeve të siguruesve me shtrirje globale.

- **Matja me bazë tregu e vlerës së pasiveve** - Tema trajtoi metodologjinë e matjes me bazë tregu të pasiveve në kuadrin e Solvency II dhe veçanërisht në përzgjedhjen e normave të përshtatshme të skontimit të flukseve të ardhme monetare dhe konceptit të ri të primit të likuiditetit.

- **Llogaritja e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese në modelet standarde** - Tema trajtoi qasjen e përgjithshme të një sistemi rregullator me bazë risku në përcaktimin e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, duke sqaruar konceptet e modelimit të aftësisë së ardhshme paguese, përzgjedhjes mes metrikave të VAR (Value At Risk) dhe TVAR (Tail Value At Risk), si dhe metodologji të ndryshme të agregimit të risqeve dhe llogaritjes së efektit të diversifikimit mes tyre. Prezantimi u ndoq nga një shembull praktik, i organizuar si punë në

grupe, e analizës financiare të një shoqërie nga përvoja e Autoritetit Mbikëqyrës në Bermuda.

- **Projektimi dhe zbatimi i modeleve të brendshme të matjes së riskut** - Tema trajtoi shembullin praktik të tipareve të një modeli të brendshëm riksu në zbatim në shoqërinë e mirënjohur risiguruese Swiss Re, model tashmë i miratuar si model i brendshëm nën kuadrin rregullator Zviceran (Swiss Solvency test- SST) dhe nën shqyrtim për miratim nën Solvency II.

- **Stres testing dhe metoda e skenareve** - Tema trajtoi mangësitë e modeleve të kuantifikimit të riskut, të cilat mund të anashkalohej me përdorimin e stres testingut dhe metodës së skenareve, ndryshimet mes këtyre dy metodave, hapat bazë në ndërtimin e skenareve dhe llojet e tyre, hetimin e detajuar të marrëdhënieve të ndërvarësisë që ekzistojnë mes pasojave të ndryshme në një skenar realist, si dhe shembuj realë të skenareve të ndryshme ekonomike (kriza ekonomike/buxhetore në Eurozonë) dhe jo-ekonomike (epidemi globale).

- **Modelimi i aktivitetit të grupeve shumëkombëshe të sigurimit** - Tema u përqëndrua në hartimin, për qëllime rregullatore dhe të përdorimit vetjak të modeleve aktuariale të aktivitetit të grupeve shumëkombëshe të sigurimit, duke u përqëndruar në sfidat unike të njësisve të tilla, ndryshimit të sjelljes së grupeve gjatë streseve të ndjeshme financiare, modelet agregative dhe individuale të grupeve, si dhe praktikën e arbitrazhit rregullator në kushtet e sistemeve si Solvency II dhe SST.

- **Miratimi i modeleve të brendshme të siguruesve** - Tema trajtoi metodologjinë e aplikimit për miratim, si dhe kontrollit të modeleve të brendshme aktuariale të siguruesve, zëvendësues të modelit standard nën regjimin e SST-së, duke u përqëndruar në ndërthurjen e modelit me metodën e skenareve, justifikimin e metodologjisë dhe parametrave, trajtimin e metodës së portofolit replikues në vlerësim, si dhe praktikën e Autoritetit Mbikëqyrës Zviceran me miratimin e modeleve të brendshme.





## Edukimi i konsumatorit

### Bazat e Risigurimit

(Material i përpunuar, i autorit Rodolfo Wehrhahn, nxjerrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)

*Vijon nga numri i kaluar...*

### Pjesëmarrësit e industrisë së risigurimit

Siç u diskutua më sipër, pjesëmarrësit kryesorë në industrinë e risigurimit janë risiguruesit profesionistë, retrocionarët dhe shoqëritë e sigurimeve. Ndërmjetësit e risigurimit gjithashtu luajnë një rol themelor në vendosjen e programeve të risigurimeve, në veçanti kur trajtohen programe të veçanta. Siguruesit “captive”, rezervat e përbashkëta (pools) dhe risiguruesit e huaj plotësojnë industrinë e risigurimit.

#### *Ndërmjetësit e risigurimit*

Për programet komplekse të risigurimit ose kur kapaciteti i risigurimit është i rrallë, shoqëritë e sigurimeve përdorin shërbimet e ndërmjetësve të risigurimit. Ndërmjetësit e risigurimit janë shoqëri ose individë profesionistë që janë të licencuar dhe të mbikëqyrur, të cilët i përkushtohen dhënies së këshillimeve profesionale shoqërive të sigurimeve për investimin e programeve të tyre të risigurimit. Ndërmjetësit e risigurimit paguhen nëpërmjet komisioneve të risigurimit, që janë në përpjesëtim me primin e investuar të risigurimit. Ndërmjetësit e risigurimit ofrojnë gjithashtu shërbime administrative dhe zhvillim produkti. Në shumicën e juridiksioneve ndërmjetësve të risigurimit u kërkohet që të mbajnë një policë për përgjegjësinë e gabimeve dhe neglizhencave për mbrojtjen e shoqërive të sigurimeve.

Në vitet e fundit, shtypi ka raportuar skandale të mëdha financiare që lidhen me mungesën e transparencës së komisioneve të risigurimeve.

Ndërmjetësit profesionistë të risigurimit kanë

reaguar duke ofruar publikime të detajuara të komisioneve të tyre.

#### *Siguruesit “captive”*

Konglomeratet e mëdha industriale që janë të interesuara për të mbajtur risqet e tyre brenda grupit zakonisht operojnë me një sigurues specifik “captive”. Një kaptiv është një ent ligjor, zakonisht një shoqëri sigurimesh aksionare, e cila zotërohet nga grupi që pranon dhe mban risqet që lindin vetëm nga i njëjti grup industrial.

#### *Rezervat e Përbashkëta (pools)*

Shoqëritë e sigurimeve mund të duan të sigurojnë një lloj të pazakontë ose të ri risku por kanë frikë se nuk do të kenë biznese të mjaftueshme të atij tipi për të përfitur nga ligji i numrave të mëdhenj. Në një rezervë të përbashkët, disa shoqëri bien dakord që t'i ndajnë risqet e tyre të këtij tipi. Kjo do të garantojë një mostër mjaft të madhe për të dhënë rezultate më të parashikueshme dhe konsistente nga viti në vit. Rezerva mund të risigurohet ose ndarja e çdo police në rezervë mund të jetë në përputhje me sasinë e biznesit që çdo shoqëri vendos në rezervë ose mund të jetë një formulë që lidhet me sasinë e riskut që çdo shoqëri do të pranonte në çdo rast. Krijimi i rezervës së përbashkët në fakt ishte mënyra se si filloi sigurimi i avionëve modernë të pasagjerëve. Banka Botërore ka promovuar rezervat për të mbuluar risqet katastrofike si Grupimi Turk i Sigurimit Katastrofik (TCIP) dhe Fasiliteti i Sigurimit të Riskut Katastrofik të Karaibeve (CCRIF).

#### *Risigurimi i huaj*

Shoqëritë e huaja të risigurimit janë risigurues që operojnë në zona të veçanta gjeografike, shpesh me mjedise tatimore më pak rregullatore kërkuese dhe të favorshme. Një pjesë e madhe e risigurimit kryhet nëpërmjet këtyre qendrave, megjithëse mjaft prej drejtimit faktik të këtyre shoqërive kryhet në zyrat mëmë të vendit në

risigurimit të huaj ka qenë që të optimizohej përdorimi i kapitalit dhe të krijohej kështu avantazhi konkurrues. Megjithatë, kur përfshihet risigurimi i huaj kërkohet një shqyrtim i veçantë. Mungesa e një rregulloreje strikte ose e kërkesave të ulëta për kapitalin në disa qendra të huaja mund të çojnë në dështimin e risiguresve në rastin e pretendimeve të mëdha. Edhe aktiviteti i pastrimit të parave e ka përdorur këtë lloj risigurimi në të kaluarën.

### Çështje rregullatore dhe të mbikëqyrjes<sup>1</sup>

Autoritetet në shumë vende po shqetësohen për cilësinë e risigurimit të blerë nga siguruesit vendas. Krediti i risigurimit, që i jepet ceduesit në formën e një rezerve ose reduktimi të kapitalit, mund të justifikohet vetëm në qoftë se risiguresi ka të paktën të njëjtën aftësi paguese, si dhe shoqëria siguruese. Kërkohet sigurimi minimal për të operuar si risigures dhe shuma e kreditit të risigurimit të dhënë do të varet nga cilësia e sigurisë. Në disa juridiksione, kërkohet kapitali shtesë kur përdoren risigures me përqindje të ulët.

Virtualisht çdo mbikëqyrës sigurimesh në botë ka të drejtën të monitorojë rregullimet e risigurimit për siguruesit e brendshëm dhe të kërkojë që ata të forcohen. Informacioni i rregullt mbi risiguresit mund të merret nga autoritetet mbikëqyrëse në adresën e tyre ligjore.

Risiguresit profesionistë luajnë një rol të rëndësishëm lidhur disi me mbikëqyrjen. Risiguresit imponojnë disiplinë tek shoqëritë e risiguruara veçanërisht tek tregjet në zhvillim. Janë risiguresit që ju thonë atyre se çfarë rezervash të mbajnë dhe çfarë primesh të vendosin. Në vendet ku nuk ka rregullore sigurimi, ky është një rol tepër i rëndësishëm që luajnë risiguresit.

### Çështje të kontabilitetit dhe kontrollit

<sup>1</sup> Seksionet e mbetura të modulit janë marrë nga një kurs për risigurimin të kryer nga Rodney Lester dhe Serap Orguz nga Banka Botërore.


Kontabiliteti i risigurimit është shumë kompleks dhe këtu mbulohet vetëm pjesërisht. Më vonë në këtë seri do të botohet një modul që i dedikohet kontabilitetit për aktivitetet e sigurimit.

Për shkak të rëndësisë së risigurimit në ndikimin e financave të shoqërive siguruese, struktura e qeverisjes së siguruesit duhet të sigurojë që bordet të kenë interes të veçantë në këtë çështje dhe sistemet e kontrollit të brendshëm të sigurojnë që të ketë një program të përshtatshëm të risigurimit.

### Kuptimi i traktatit të risigurimit

#### Formati i traktatit

Një traktat risigurimi në terma shumë të përgjithshme përcakton pagesat midis shoqërive të sigurimeve. Në formë diagrame duket si më poshtë:



Në këtë diagramë Shoqëria 1 i cedon biznesin risiguresit. Traktati kërkon që Shoqëria 1 të bëjë pagesat ose t'i transferojë fondet risiguresit. Këto pagesa zakonisht quhen diçka e ngjashme me (1) prim depozite, (2) prime vjetore (3) të ardhura investimi dhe (4) pagesë risku. Jo të gjithë traktatet do të kenë të gjithë këto zëra dhe disa të tjera mund të kenë më tepër.

Risiguresi duhet t'i bëjë edhe pagesa ose t'i

transferojë fonde Shoqërisë 1. Këto pagesa do të quhen diçka e ngjashme me (1) komisione risigurimi, (2) pagesa shpenzime, (3) dëmshpërblimet dhe (4) rritje në rezerva. Përsëri jo të gjithë traktatet do të kenë të gjitha këto zëra dhe disa mund të kenë më tepër.

Traktati mund të ketë edhe një dispozitë për ndarjen e fitimit me Shoqërinë 1 dhe kjo ndarje e fitimit njihet me emra të tillë si ndarja e fitimit, rifinancimi i përqindjes së përvojës ose pagesë fitimi ose komision fitimi. Në shumicën e rasteve pagesat midis shoqërive netohen në mënyrë të tillë që ndodh vetëm një transferim fondesh. Kjo quhet e drejta e kompensimit.

Secila shoqëri ka të drejtën e kompensimit për atë që ka borxh dhe për atë të cilën ja kanë borxh.

Fleksibiliteti në risigurim është që secili prej këtyre termave mund të përcaktohet në shumë mënyra. Ja disa gjëra që duhen kërkuar:

- Kush është risiguruesi? A është ajo një shoqëri me emër?
- Cili është përkufizimi i biznesit të risiguruar? Blloku i biznesit duhet të identifikohet në mënyrë të qartë duke dhënë datën e lëshimit, formën e policës së përdorur për biznesin, llojin e biznesit dhe çdo informacion që nevojitet për të identifikuar primet, rezervat, etj.
- Cili është risku i risiguruar faktikisht? A është ai i gjithë risku që ka marrë përsipër drejtpërdrejt shoqëria e marrë në sigurim? Në qoftë se nuk është i gjithi, a janë llogaritur rezervat përkatësisht? A janë rezervat që do të mbahen nga secila palë korrekte nga ana aktuale?
- Në cilat kushte duhet të paguajë risiguruesi? A ka likuiditet në traktat? A i duhet risiguruesit të paguajë paratë e një pretendimi menjëherë apo do të jetë në gjendje që ta vonojë pagesën?
- Në cilat kushte mund ta anulojë kontratën risiguruesi? Në anulim, cilat janë përgjegjësitë që i mbeten risiguruesit?
- Sa kohë vazhdon traktati? A është i pakufizuar

apo për një periudhë kohore të fiksuar? A do të pushojë risiguruesi së pranuari risqe të reja në një kohë të caktuar? A e ndalon ai sigurimin e risqeve që ka pranuar në atë kohë?

- Kush e mabn përgjegjësinë për dëmet afatgjata në rastet kur koha e raportimit dhe zgjidhjes së dëmit është shumë e gjatë, siç ndodh për sigurimin e përgjegjësisë dhe marinës?
- A ka ndonjë klauzolë arbitrazhi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Më poshtë përmendim disa terma standarde të një traktati risigurimi:

- Palët e marrëveshjes janë shoqëria ceduese dhe risiguruesi. Policëmbajtësi nuk përfshihet dhe për këtë arsye normalisht nuk ka dëme për risiguruesin. Në shumicën e rasteve, mbajtësi i policës nuk do ta dijë se polica është e risiguruar.
- Risigurimi zakonisht është një marrëveshje zhdëmtimi. Risiguruesi zhdëmton shoqërinë ceduese për atë që ajo paguan në dëmshpërblime.
- Të dyja palët kanë të drejtë të mbrohen kundrejt një dëmi dhe në qoftë se njëra e zgjedh që mos ta bëjë këtë, ajo do t'i paguajë pjesën e saj shoqërisë tjetër dhe do ta lërë tjetrën që të absorbojë të gjitha kostot ligjore. Në qoftë se mbrojtja është e suksesshme, shoqëria që nuk u bashkua me mbrojtje nuk merr rifinancim.
- Risiguruesi ka të drejtën të inspektojë të dhënat e shoqërisë ceduese në çdo kohë.
- Do të deklarohet zgjedhja e ligjit. Në rastin e një mosmarrëveshjeje midis palëve nuk do të harxhohet kohë duke debatuar se cili ligj aplikohet. Klauzola do të thotë se zbatohet ligji i vendit X. Zgjedhja ka më shumë mundësi që të jetë ligji i juridiksionit të paditësit.
- Klauzola e gabimeve dhe neglizhimeve thotë se gabimet e paqëllimshme sekretariale do të rregullohen në deklaratën tjetër dhe nuk janë shkak për të anuluar kontratën.
- Një klauzolë "ekuivalente nga ana aktuale" mund të kursejë faqe formulash për atë që

ndodh në qoftë se traktati ndërpritet në kohë të ndryshme. Traktati mund të thotë se diçka ndodh në qoftë se ndërprerja është 31 Dhjetori dhe në qoftë se herë të tjera do të bëhen axhustime ekuivalente nga ana aktuale.

#### Çështjet tatimore

Risigurimi që dërgohet jashtë vendit shpesh i nënshtrohet tatimit të akcizës, zakonisht nga 1% deri në 3% të primeve të risigurimit. Traktatet e tatimeve midis vendeve ndonjëherë e trajtojnë çështjen e tatimit të akcizës dhe në disa raste jepen përjashtime. Për shembull në SHBA nuk ka tatim akcize për traktatet e risigurimit me Mbretërinë e Bashkuar. Rruga që ndjek risigurimi varet shumë nga traktatet e tatimeve midis kombeve. Prandaj, risiguresit duhet të kenë njohuri të mira për këto traktate sepse tatimi prej 2% i primeve është i rëndësishëm. Një

#### Aneksi I:

##### Dëftesa e ndarjes së kuotave

Shoqëria ceduese  
Klasi i traktatit  
Biznesi  
Lloji i sigurimeve  
Mbulimi  
Data e fillimit  
Data e skadimit  
Monedha  
Kufiri për person  
Mbajtje  
Pjesa e risiguresit  
Përqindjet vjetore të primit  
Mbulimi i jetës  
Shtesa  
Komision  
Përjashtime  
Raporti kontabilist  
Pagesa e bilancit

konsiderim tjetër është mbajtja e tatimit mbi dividendët që shoqëritë e risigurimit u paguajnë shoqërive mëmë. Mungesa e këtij tatimi mbajtjeje ose përjashtimi brenda traktatit tatimor ndikon edhe në aktivitetin e risigurimit.

#### Vërejtje konkluduese

Kompleksiteti i biznesit të risigurimit është trajtuar në shumë publikime. Kryesisht çdo risigures profesionist ofron materiale mësimore të shkëlqyera që shkojnë nga çështjet bazë deri në çështjet komplekse. Ne kemi synuar këtu që t'i japim lexuesit mjaft informacion që ai të njihet me konceptet bazë të risigurimit në mënyrë të përmbledhur. Në të njëjtën kohë, shpresojmë që kursi do t'i lejojë dhe do ta inkurajojë lexuesin që të kërkojë më tej literaturë për të plotësuar nevojat individuale të njohurive për këtë çështje.

Siguruesi A  
Ndarja e kuotave (Quota Share)  
Grupi I punonjësve  
Me afat 5 vjeçar  
Vdekja nga çdo shkak dhe vdekje aksidentale  
1 Janar 2002  
31 Dhjetor 2002  
US\$  
1.000.000 US për person dhe për përfitim  
20% me një maksimum prej 200.000 US\$  
20%  
1.75%  
1.216%  
10%  
Përjashtimet e policës  
Mujor  
Mujore

**Aneksi II:****Dëftesa e ndalimit të humbjes**

Shoqëria ceduese	Siguruesi A
Metoda e risigurimit	Ndalimi i humbjes (Stop Loss)
Risqet e mbuluara	Polica të grupit të lëshuara
Përzgjedhje e riskut	Sipas dokumentacionit të paraqitur
Territori	Në të gjithë botën për policat e marra në sigurim në vendin e shoqërisë ceduese
Përparësia	Kufiri i përparësisë për këtë mbulim do të jetë 95% primit neto.
Mbulimi	Kapaciteti i kontratës 30% i primit neto fillestar që i korenspondon risqeve të mbuluara. Maksimumi: 30 milionë US\$.
Dëmet	Risiguruesi do të paguajë 90% të të gjithë dëmeve që u korenspondojnë risqeve të mbuluara mbi përparësinë. Shoqëria ceduese do të kryejë për llogarinë e saj bashkëpagesën që rezulton për humbjen 10%.
Fillimi	1 Janar 2005
Skadimi	31 Dhjetor 2005
Përqindja	6% priti fillestar neto që u korrespondon risqeve të mbuluara
Primi minimal	3 milionë US\$
Primi i depozitës	2 milionë US\$
Pagesa e primit	Katër këste të pagueshme në fillim të çdo tre mujori. Tre mujori i parë më 1 shkurt 2005
Shlyerjet	Primet dhe humbjet do të llogariten me monedhën vendase. Shlyerjet do të bëhen me US\$ bazuar në kursin e këmbimit në kohën kur duhet paguar primi
Raportimi i humbjeve	Të gjitha humbjet në çdo tre mujor
Ndarja e fitimeve	Nuk ka ndarje fitimesh
Klauzolat	Aplikohen klauzolat standarde të risiguruesit

*Vijon në numrin tjetër...*

***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, A. Dervishi, J. Sokoli,  
E. Sherri, E. Basha, R. Eltari, E. Kokona

